

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Emine Mustafa kryetare e kolegjit, Nebojša Boričić dhe Avdi Dinaj anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit T. K. për veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPK, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të të dënuarit T. K., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm P.nr.1913/14 të datës 21.08.2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1618/15 të datës 24.03.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 08.06.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e të dënuarit T. K., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm P.nr.1913/14 të datës 21.08.2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1618/15 të datës 24.03.2016.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.1913/14 të datës 21.08.2015, të dënuarin T. K. ka shpallur fajtor për veprën asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPK, për të cilën veprën i ka shqiptuar vërejtje gjyqësore dhe është obliguar që t'i paguaj shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 20 euro në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Vendimi i Gjykatës së Apelit

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka paraqitur i dënuari, mirëpo Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin PA1.nr.1618/15 të datës 24.03.2016, ka refuzuar si të pabazuar ankesën dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e ankimuar.

Paraqitësi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe pretendimet e tij.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar i dënuari T. K., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, pa i precizuar se cilat dispozita janë shkelur me këto aktgjykime.

Opinionit i Prokurorit të Shtetit lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.79/16 të datës 24.05.2016, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit T. K. të refuzohet si e pabazuar.

Gjetjet e Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesave, dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë i dënuari jo vetëm që nuk i thekson bazat për të cilat ka paraqitur kërkesë, por nga referati i kërkesës nuk thekson asgjë që kishte për tu vlerësuar nga ana e kësaj Gjykate, por vetëm përshkruan arsyetimin e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Konform nenit 436 par.1 të KPPK, me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosoves kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon, e në rastin konkret i dënuari nuk ka paraqitur asnjë shkelje ligjore.

Vlenë të theksohet se i dënuari gjatë tërë procedurës gjyqësore ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale dhe vullnetarisht ka pranuar fajësin dhe ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe se janë respektuar të gjitha dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me pranimin e fajësisë. Andaj, Gjkata e Apelit drejtë ka vlerësuar se ndaj aktgjykimit nuk mund të ushtrohet ankesë për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike kur ka marrëveshje mbi pranimin e fajësisë apo kur i akuzuari ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës dhe trupi gjykues është pajtuar me pranimin e tillë .

Prandaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktgjykime duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pml.nr.113/16 të datës 08.06.2016.

Procesmbajtësja,
Qefshere Berisha

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa